

REPUBLIKA E SHQIPËRISË DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI ADRESA Rruga "Muhamet Gjollesha, Pall. Moskat, shk 3, ap 14" TEL: 692204572

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 524

Nr. koleksioni: 313

Tirane më 06/02/2024


Margalina Dauti Firmosur elektronikisht nga NISA me certifikaten :Margalina Dauti Data: 2024.02.06 17:51:50+01:00

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024050360028367722



# KONTRATË SHITJE ME KUSHT KUOTË KAPITALI (TË SHOQËRISË "SEAN" SH.P.K)

Sot, më datë <u>06.02.707</u>, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Muhamet Gjollesha, Pall. Moskat, shk 3, ap 14", u paraqit personalisht:

#### PALA SHITËSE:

**Aulona Gaxhenji**, atësia Valentin, amësia Polikseni, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banuese në TIRANË, me adresë Mihal Grameno; Nd. 41; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 03/07/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035167526 dhe nr. personal I55703084S.

#### PALA BLERËSE:

Shoqëria "FINVEST" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M31708039K, me adresë Rruga Sami Frasheri,Ndertesa 23,Apartamenti 1, përfaqësuar nga Administratori Julian Dhima, atësia Mihal, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në FIER, me adresë Jakov Xoxa 01490116; Nd. 15; H. 17; Ap. 2; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 08/06/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036532576 dhe nr. personal H90608078D.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "SEAN" SH.P.K, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

#### **BAZA LIGJORE**

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij; Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"; Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Shoqeria "SEAN" SH.P.K., eshte themeluar në Shqipëri me date 24/06/2021 dhe ka nje kapital prej 100.000,00 (njeqind mije leke) te ndare ne 1 kuote, dhe te zoteruar 100% nga ortakja Aulona Gaxhenji.

**DUKE QENE SE** Shitesja **Aulona Gaxhenji** deshiron te shesi kuotat e saj qe perbejne 100 % te kapitalit te shoqërisë "*SEAN*" SH.P.K, dhe Bleresi ne ekzekutim te kesaj Kontrate shpreh vullnetin ti blej keto kuota te shoqerise "*SEAN*" SH.P.K, sipas percaktimeve dhe kushteve te vendosura ne kete kontratë.

NE PERPUTHJE ME SA ME SIPER u parashtruan, premtimet e ndersjella, marreveshjet, perfaqesimet dhe garancite e permbajtura ne kete dokument, si edhe sipas percaktimeve dhe kushteve te vendosura ne kete kontratë, Shitesi dhe Bleresi bien dakord si vijon:

Cdo marreveshje paraprake e arritur mes paleve sa me siper pranohet dhe miratohet si pjese e dispozitave vazhduese.



#### Neni 1 Palët e kontratës

- 1. Palët e kësaj kontrate janë:
  - a. Aulona Gaxhenji, referuar ne kete kontrate si Shitësi; dhe
  - b. Shoqëria "FINVEST" sh.p.k, referuar ne kete kontrate si Blerësi;
- 2. Palët dhe/ose përfaqësuesit e palëve sa më sipër gëzojnë të gjitha tagrat për të përfaqësuar personin e tyre fizik në pranimin e termave të kësaj kontrate dhe nënshkrimin e saj.
- 3. Palët i kanë paraqitur njëra tjetrës gjithë autorizimet që legjitimojnë praninë e tyre në këtë kontratë dhe i kanë pranuar ato si të vërteta dhe të rregullta.

## Neni 2 Objekti i kontratës

Objekti i kesaj kontrate eshte shitblerja e 100% te kapitalit te shoqerise "SEAN" SH.P.K., te zoteruara nga ortaku i vetem Aulona Gaxhenji.

Kuotat do ti shiten Shoqërisë "FINVEST" sh.p.k.

Ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate Shitje Kuotash ortaku i vetem i Shoqerise "**SEAN**" Sh.p.k do te jete si me poshte vijon:

1. Shoqëria "FINVEST" sh.p.k zoteron 100 % te kuotave,

lidhur me kryerjen e pageses sipas kesaj kontrate.

## Neni 3 Baza ligjore

Kalimi i kuotave me kete kontrate bazohet ne nenin 73 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret; dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

## Neni 4 Garancitë e ndërsjella

Shitesi garanton Bleresin se eshte pronar me te drejta te plota mbi objektin e kontrates, e zoteron te plote dhe te lire e pa asnje barre renduese dhe se te gjitha garancite e treguara dhe te pranuara nga Bleresi, vazhdojne te mbeten te vlefshme deri ne ekzekutimin e plote te kesaj kontrate si dhe ne çdo moment pas permbushjes se kontrates.

#### Neni 5 Vlera e kontratës

- 1. Pala Shitese ka rene dakord t'ia shese Pales Blerese objektin e kesaj kontrate, me nje cmim prej 15'000'000 Lek (pesembedhjete milion lek) dhe Bleresi kane rene dakord t'ia bleje Shiteses perkatesisht objektin e kesaj kontrate, me kete cmim.
- 2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, palet deklarojne dhe pranojne qe bleresi te likujdoje me keste, nepermjet bankes, vleren e blerjes se kuotave duke depozituar ne numrin e llogarise se pales shitese brenda nje viti (afat i cili fillon nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate deri e plotesimin e afatit 1 vjecar) vleren totale prej 15'000'000 Lek (pesembedhjete milion lek). Vlera e shitblerjes do te konsiderohet e likujduar me depozitimin e mandateve te bankes prane kesaj zyre, te cilet do te jene pjese perberese e kesaj kontrate dhe Shitesi nuk ka me asnje pretendim

#### Neni 6 Transferimi i kuotës

1. Palet bien dakort qe menjehere pas nenshkrimit te kontrates te behet transferimi i kuotës ne emer te pales blerese dhe kuota te bllokohet ne emer te pales shitese, deri ne momentin e likujdimit te vleres totale te shitjes.



A2024050360028367722

- 2. Palet konfirmojne se pas ekzekutimit te kesaj kushteve te kesaj kontrate Shoqëria "FINVEST" sh.p.k do te jetë ortaku i vetem te shoqerise "SEAN" SH.P.K, duke zoteruar 100 % te kuotave.
- 3. Pas transferimit te kuotes ne favor te pales blerese, ne ekstraktin e shoqerise do te rezultoje i regjistruar inskripti sipas te cilit kuota eshte e bllokuar ne favor te Aulona Gaxhenji, deri ne momentin e likujdimit te vleres totale te shitjes, me qëllim pengimin e ndryshimit te statusit dhe shitjen e kuotes se blere nga pala blerese, deri ne përmbushjen e plotë të detyrimit që ka ndaj pales shitese ne zbatim të kesaj kontrate.
- **4.** Me likujdimin e çmimit të shitjes së kuotes, pala shitëse ka detyrimin të paraqitet pranë zyrës së noterisë për të nënshkruar deklaratën noteriale të likujdimit të cmimit total te shitjes, e cila do te depozitohet pranë QKB për të bërë fshirjen e inskriptit/ bllokimit "në favor të palës shitëse" nga ekstrakti i shoqerise.

# Neni 7 Detyrime të shitësit dhe blerësit

Shitesi dhe Bleresi kane detyrimin qe te permbushin me rigorozitet kushtet e percaktuara ne kete kontrate.

Shitesi dhe Bleresi jane pergjegjes ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave, nga casti i kalimit te kuotave deri ne regjistrimin e kalimit te tyre ne regjistrin tregtar.

Pala Blerese deklaron se merr persiper te pergjigjet perkatesisht per detyrimet fiskale qe mund te aplikohen per shkak te kalimit te kuotave, dhe cdo detyrim te mundshem qe ka Shoqeria aktualisht apo qe mund te lindin ne te ardhmen.

#### Neni 8

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët angazhohen qe te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarreveshjet qe lindin gjate permbushjes se kesaj kontrate. Ne rast te mos zgjidhjes se mosmarreveshjeve me mirekuptim, palet kane te drejte ti drejtohen Gjykates se Tiranes.

### Neni 9 Anekset e kontratës

- 9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Anekse të Kontratës;
  - Vendimi i Asamblesë së Ortakëve
  - Ekstrakt i Regjistrit Tregtar për Shoqërinë "SEAN" SH.P.K;
  - Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
  - Faturë e transfertës bankare;
  - Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

#### Neni 10

#### Dispozitat përfundimtare

- 13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.
- 13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Fq. 3



A2024050360028367722

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

# PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE AULONA GAXHENJI

PALA BLERËSE Shoqëria "FINVEST" sh.p.k përfaqësuar nga Administratori

JULIAN DHIMA

NOTERE

MARGALINA Y. DAUTI